



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:177740

Datë: 26.11.2021

Numri i dokumentit: 02447142

P.nr.1009/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM me gjyqtarin e vetëm gjykues Ngadhnjim Arrni, zyrtaren ligjore Kaltrina Qollaku, në çështjen penale kundër të pandehurit H...M..., nga Prishtina, për shkak të veprës penale – Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës jashtë seancës, duke vendosur konform nenit 358 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së, me datë 03.11.2021 merr këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë me nr. PP/II.Nr.8006/17 e datës 28.02.2018.

PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit **H...M...** nga i ati Ademi, i lindur me dt.15.04.1965, me vendbanim në P... në Zonën Industriale, afër market “Maxi”, me numër personal 1010836626, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i akuzuar për veprën penale – Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, për shkak se ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale me datë 28.02.2021.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

E dëmtuara:, KEDS me seli në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën PP/II.Nr.8006/17 të datës 28.02.2018, ka akuzuar të pandehurin H...M... nga Prishtina, për shkak të veprës penale – Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, dhe njëherësh ka propozuar që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Në gjykatë Aktakuza është pranuar me datë 28.02.2018 ndërsa gjyqtarit të çështjes lënda i është caktuar me datë 18.02.2021. Duke vepruar në këtë çështje, me rastin e rishikimit të shkresave të lëndës dhe jashtë seancës u konstatua se ka arritur afati i parashkrimit të ndjekjes penale me datë 28.02.2021.

Kjo për arsye se, për veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Sipas nenit 106 par.1 pika 1.5 të KPRK-së, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim. Në rastin konkret, vepra penale është kryer me datë 12.10.2017, ndërsa aktakuza është pranuar në Gjykatë me datë 28.02.2018. Që nga koha e pranimit të aktakuzë në këtë gjykatë nuk është

ndërmarrë asnjë veprim me qëllim të gjykimit të veprës penale dhe që nga data 28.02.2018 kanë kaluar më shumë se tre (3) vite, andaj gjykata konstaton se në këtë çështje penale parashkrimi i ndjekjes penale ka arritur me datë 28.02.2021 dhe pas kësaj date Gjykata nuk mund të ndërmerr asnjë veprim me qëllim të gjykimit të kësaj vepre penale.

Afati i parashkrimit po ashtu ndërpritet kur kryesi para skadimit të afatit të parashkrimit kryen një vepër tjetër penale me peshë të njëjtë ose më të rëndë se sa vepra penale e mëparshme, në rastin konkret nga të dhënat e kësaj gjykate nuk rezulton se i njëjti ka ndonjë aktgjykim të formës së prerë me të cilën do të konstatohet se pas kësaj vepre penale i njëjti ka kryer ndonjë vepër tjetër penale, andaj gjykata konstaton se në rastin konkret nuk është ndërpre rrjedha e parashkrimit dhe ka ardhur deri tek parashkrimi i ndjekjes penale.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori konform nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Konform dispozitave ligjore të nenit 463 par.1 dhe 3 të KPPRK-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Andaj, konform nenit 358 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që ekzistojnë rrethana të cilat pengojnë ndjekjen penale.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1009/18 me datë 03.11.2021**

**Gjyqtari
Ngadhnjim Arrni**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej tri ditësh nga koha e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:177740
Datë: 26.11.2021
Numri i dokumentit: 02447142